

# PËR NJË KOSOVË



# DEMOKRATIKE

## NE DHE DEMOKRACIA

ENDI (13), ANILA. A(13) BLERINA (14), ERDETI(13), ANILA.A (13), GRANITI (13), ENES (12), LEONITA(13)

### Implementimi i demokracisë

Demokracia është sistem i qeverisjes, që buron nga populli. Hapat e parë të demokracisë filluan në Athinë të Greqisë. Një shtet demokratik është atëherë kur ka tolerancë pavarësisht racës, kombit, besimit, etj. Ne si qytetarë kemi lloje të ndryshme të të drejtave si p.sh.: e drejta e jetës, e drejta për të pasur një emër, e drejta për shkollim etj.

Qytetarët e një vendi demokratik janë të lirë t'i shprehin pakënaqësitë e tyre edhe përmes protestave. Paqja është një element i rëndësishëm për ne si popull demokratik. Për të zgjedhur drejtuesin e shtetit na duhet vota jonë. Pra, ne e formojmë demokracinë përmes pjesëmarrjes aktive në të.



Barazia gjinore



Barazia racore dhe fetare



E drejta e shkollimit



Jeta në demokraci

# ÇFARË ËSHTË NË TË VËRTETË KUVENDI?

LUANIT(13), EROLL(13), FESTINA(13), AURELA(13), ALMA(13), VALON(15), MELOS(13)



## Kuvendi, ligjet dhe komisionet parlamentare

Disa njerëz pyesin se çfarë do të thotë fjala ligj me të vërtetë. Me ligj nënkuptojmë rregullat shoqërore të cilat duhet të zbatohen. Deputetët të cilët përfaqësojnë popullin mbledhen në Kuvend së bashku me Qeverinë për të propozuar ligjet. Çdo ligj duhet të përshtatet me interesat e popullit. Kjo mbledhje në Kuvend quhet seancë plenare.

Propozimet që bëhen nga p.sh. deputetët dhe Qeveria shqyrtohen nga komisionet për degë të ndryshme. P.sh. nëse nga Qeveria propozohet ligji për arsimin fillor ku njëri nga nenet përshkruan se, secili fëmijë ka të drejtë për arsimin fillor, këtë ligj e kontrollon komisioni për arsim. Një shembull tjetër është kur jepet një ligj për kujdesin shëndetësor, këtë ligj e shqyrton

Komisioni për Shëndetësi.

Këto ishin disa shembuj për të treguar rolin e komisioneve parlamentare. Pra, Kuvendi është pushtet legjislativ. Në Kuvendin e Kosovës bëjnë pjesë 120 deputetë ku prej tyre 20 vende janë të rezervuara për komunitetet jo shumicë. Në Kuvend votohet për buxhetin e vendit.


Struktura dhe funksionet bazë të Kuvendit rrjedhin prej kushtetutës. Kushtetuta është akti më i lartë juridik. Ajo bazohet në parimet e lirisë, paqes dhe demokracisë ku garantohen të drejtat themelore të njeriut. Pra, funksionet themelore të Kuvendit janë: funksioni legjislativ, përfaqësues dhe i kontrollit. Në sistemin demokratik secili votues e ka të drejtën të votoj atë që dëshiron. Votuesi duhet të jetë mbi moshën 18 vjeçare.





## QYTETARËT NË DEMOKRACI


ERZA (13), ARBËR (13), ALBERT (13), ARDIT (14), EMIR (13), LYRA (13), FEHMI (13), BLEON (13)



### Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve

Në shtetin tonë demokratik ka shumë të drejta dhe përgjegjësi, por edhe rregulla dhe ligje. Ne si qytetarë kur arrijmë moshën 18 vjeçare, e kemi të drejtën e votimit, e kemi të drejtën e shprehjes së mendimit dhe të fjalës. Gjithashtu, kemi të drejtën e shkollimit, ku shkollimi fillor dhe ai i mesëm i ulët janë të obligueshëm dhe pa pagesë. Këto të drejta të cilat i cekëm më lartë mbrohen nga organe të ndryshme ligjore. Disa nga këto organe mbrojtëse janë: Institucioni i Avokatit të popullit, pastaj është organizata „Save the children“ që i mbrojnë të drejtat e fëmijëve etj.

Mirëpo, kemi edhe përgjegjësitë tona. Disa nga këto përgjegjësi janë: mbrojtja e mjedisit, ku ne kemi një shembull konkret për këtë përgjegjësi. Një ditë në Prishtinë ishte duke ecur një qytetar, ku papritmas i rastisi një mbeturinë në tokë dhe e morri e futi në shportën e mbeturinave. Pastaj e takoj një shok të tij në anën tjetër të trotuarit dhe duke kaluar rrugën u ndez drita e kuqe e semaforit dhe padyshim që ai ndaloi dhe priti derisa u ndez drita e gjelbër e semaforit (respektimi i rregullave të komunikacionit). Pra nga e gjithë kjo që sot mësuam është se ne duhet të kujdesemi për vendin tonë, në mënyrë që edhe ne sikurse vendet e tjera demokratike të jetojmë si duhet.



Ne e respektojmë hapësirën se ku jetojmë



Ne si qytetarë i kryejmë obligimet tona

## INSTITUCIONET DEMOKRATIKE

HARIS (13), JON (13), VENIS (13), ELSA (13), BUKURIE (13), VERON (13), ENGJËLL (13)

### Sot gjatë vizitës tonë në Punëtorinë e Demokracisë zgjeruam shumë njohuri tona rreth demokracisë dhe ndarjes së pushtetit

Kuvendi i Kosovës përfaqëson shtetin dhe popullin. Kuvendi miraton, shfuqizon dhe propozon ligje. Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Qeverisë. Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë dhe së paku 30% e tyre duhet të jenë të gjinisë femërore.

Qeveria ashtu si edhe Kuvendi ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Ajo përbëhet nga Kryeministri, zv. kryeministrat, ministrat dhe zv. ministrat. Disa nga ministritë janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë etj. Detyrat e Qeverisë janë të propozoj ligjet, buxhetin, merret me politikat e jashtme dhe të brendshme të shtetit, etj. Gjykata është institucion shtetëror i cili merret me drejtësinë. Kemi tri lloje të gjykatave. Ato janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.



Elsa i tregon Engjëllit se respekti është element shumë i rëndësishëm në demokraci



Gazetarët duke punuar



Gazetarët e rinjë



Mendimi i Veronit



Mendimi i Jonit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë